REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA
02-02-2026
01-110/05-276

Republika e Kosovë
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipalty of Viti

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 27.02.2026 miraton këtë:

# V E N D I M

**për caktimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal të Vitisë, të cilët do të përfaqësojnë komunën e Vitisë në Asociacionin e Komunave të Kosovës**

**Neni 1**

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për emërimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal të Vitisë, të cilët do ta përfaqësojnë Kuvendin Komunal të Vitisë në Asociacionin e Komunave të Kosovës.

**Neni 2**

Kryetari i Komunës shkon direkt, ndërsa tri partitë politike më të mëdhaja në Kuvendin Komunal të Vitisë propozojnë nga një përfaqësues:

1. Basri Aliu Përfaqësues nga LDK-ja,
2. Nuhi Ramadani Përfaqësues nga PDK-ja,
3. Jakup Demiri Përfaqësues nga LVV-ja.

**Neni 3**

Anëtarët e emëruar në neni 1 të këtij vendimi emërohen me mandat të njëjtë si të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë.

**Neni 5**

Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr.08/L284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Nr.08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024), dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare, në web faqe të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I
Bekim Azizi